

BIBLIOTEKA
SHETIT

814-1
J.76.

Zhuljana
Jorganxhi

POEZI

RIJUE



Zhuljana G. Jorganxhi.

lindi në qytetin e Korçës, më 1946. Shkollën e mesme të arësimit të përgjithshëm e kreu në qytetin e lindjes. Më 1969 mbaroi fakultetin Histori-filologji, në degën gjuhë-letërsi dhe kursin 2 vjeçar të gazetarisë, pranë fakultetit të shkencave politike-shoqërore.

Më 1969 botoi vëllimin e parë poetik «Net promovimesh». Ka filluar të botojë që në vitin 1964.

Tani punon si gazetare në revistën «Shqiptarja e Re».

Ky është libri i saj i dytë.

85H-1
776.

ZHULJANA G. JORGANXHI

RRITJE

— Poezi —



12747

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PORTRETI YT, NËNË

Nga ta nis portretin tënd të dli­rë,
që duart e tua mbi vargjet e mia të mbështeten,
zemra jote në to të rrahë mirë
dhe frymëzimi im në rrugë të mos mbetet?

Sa herë të pashë fushave, mes malesh,
ku si boçe pambuku feks shami e bardhë;
e vështrova mirë veten edhe vargjet
dhe kërkova në to kallot ku i kanë.

Duart e tua, duart e jetës,
vij­në e na mbështeten zemrës edhe ballit,
janë po ato duar që dikur me dhembje
u lidhën plagët shokëve të malit,

qershor 1973

NË DEKADËN E MAJIT

Violinist,
një minutë heshtje...
Kjo violinë na kujton Qemalin
dhe ky koncert do të jetë i tij!
Ti mblidhi tingujt dhe si përrënjtë e malit
derdhi mbi gjithë këtë qetësi.

Bjeri violinës, djalosh!
Kjo dekadë maji Qemalin e uli në sallë.

1972

DASHURI DHE URREJTJE

Ti më the: «Bota është e madhe
dhe, që ta njohim atë, duhet shumë
DASHURI dhe URREJTJE.
Më parë duhet të mësojmë
çfarë të urrejmë, çfarë të dashurojmë.»

Të urrejmë dhe të dashurojmë.
Dashuria me urrejtjen
në zemrat e popujve pranë e pranë qëndrojnë.

Të duam
këtë tokë ku zuri fill jeta jonë,
siç zë fill dita me mëngjezin,
pranvera me lulet e mimozës.

Të duam
jetën tonë,
njerëzit që ndërtuan këtë rrugë.

Këtë rrugë që na nisi në rrugë të reja,
këtë rrugë ku ecën dashuria
e shëndetshme, e fortë.

Kufijve të lirisë
zemrat tona
u vëmë piramidë.
Piramidat midis dashurisë dhe urrejtjes
t'i vendosim mirë brenda vetes.

SHOQES KANDIDATE PARTIE

Sonte dritat e kësaj salle do të shuhen vonë...
Ne flasim për ty,
për rrugën tënde...
Mbi një fletë biografie atë e shkrove.
Ti rende
mbi këto rreshta të kuqe.

1970

PARA DËSHMOREVE TË LIRISË

...Edhe një grusht... Një grusht
të pi dua,
të pi... dhe etjen në këtë burim heroizmi s'e
shuaj dot,
këtu zemrën duhet ta kesh të madhe sa populli,
si ATA.
Guximin si gur stralli,
si lufta e tyre.
Dashurinë të pakufishme,
si dashuria e tyre,
që sa bota e madhe ish.

Në fjalorin e buzëve të tua të kesh
fjalët që ATA thanë,
ato që buzëve iu mbetën,
këngët e tyre...

Para se lule mbi ta të vendosësh,
duart mirë duhet t'i shohësh
a iu ngjajnë të tyreve.
ATA ndër duar mbanin pushkën,
ashtu si mbajnë nënat djepin e fëmijës.

1973

KUR MUNGON TI, Z.

Çudi si u rënduakan orët,
minutat
pa ty.
Dhe unë mendothem t'i shtyj,
t'i shtyj...
(Kurse me ty më duken të lehta,
të lehta,
të lehta!)
Tani kuptoj,
pse zogu me një krah nuk fluturon.

1972

M E S H I R Ë

Nga gjithë gjërat më e neveritshmja më dukesh,
mëshirë...

Ti krahët e tu të thatë i shtrin
dhe prej tyre çdo zemër mbetet e shushatur,
e mpirë.

Mëshirë...

Nga ç'burim i hidhur doli kjo fjalë?

Mëshirë,

ti vret më shumë se çdo gjë,

ti vret mbi të gjitha NJERINË.

1972

M O T R A

Ne motra jemi,
por shoqe çudi s'u bëmë kurrë.
Ti s'gërmovë në ëndrrat e mia;
të gjitha shqetësimet për mua
të çojnë tek një burrë.

Do të desha të ishe ndryshe...
e para në ëndrrat e mia të hyje.

1972

N E N E S

Ku shkoi freskia e fytyrës së nënës?
Ku shkoi butësia e duarve të saj?
E re gjithmonë mbeti për në
veç dashuria e saj.

Ndaj kushdó që më pyet:
«sa vjeç është nëna?»,
i përgjigjem: «Ajo është sa një NËNË!»

1972

DUART E TOKËS

Çdo ditë në tryezën time të bukës
peshojnë rëndë
duart e ashpra,
duart e tokës.

Duart e tokës,
duart e nënave,
duart e baballarëve,
rrahur prej erërave,
mbjellin bukën.

Duart e tokës,
duart e vajzave,
duart e djemve,
pjekur prej diellit,
korrin bukën.

Në tryezat tona të bukës,
fëmijët tanë,
ngopin urinë e shekujve që pas i lamë.

1973

KËTË MËNGJEZ

Vajzës së Çan Pao Y-së

Këtë mëngjez zemrën hapa
dhe thura këtë këngë për ty,
ndërsa ti je kaq larg e kaq afër,
o ushtarja e kuqe,
e vogla Çan Çun Li.

Mes dhembjes dhe forcës ti m'u çele,
vogëlushja Çan Çun Li,
ç'gjë më të bukur se heroizmi
do të sillte nga kaltërsitë babai yt?

1971

ARIN NË KUJTIM

Pedagogut tim, M. Gurakuqit

Ja tavolina!
(pa ty sikur s'e shohim dot!)
u mësuam të të kemi pranë.
Në një kornizë nekrologjie jeta s'u mbyllka,
jo!

Hapat e tua,
zërin tënd, mes zërave tanë
do ta kërkojmë
dhe do ta gjejmë,
profesor!

1972



NË SHITËPINË E VJETER

Po ngjit këto shkallë të drunjta,
që kërcasin tok me kujtimet e mia.
Këtu flenë ëndrrat e brishta,
këtu fle ëmbël fëmijnia.

Përsëri bije borë jashtë,
si copëra letre thërmuar nga qielli,
dikur këtu fëmijnia
bashkë me to më erdhi.

1972

MENDIME NË BREG TË LUMIT

E donte gjyshja, e donte këtë lumë,
ku çarçafët e bardhë i lau kaq herë
me duart e vyshkura nëpër shkumë.

E donte gjyshja, e donte këtë lumë,
që llërët e këmbët i lagu gjithë jetën,
veç kurmin e bardhë nuk ia pa ai kurrë.

E donte gjyshja, e donte këtë lumë,
ku lopës kaq herë ujë i dha
nën murmuritjen e tij plot zhurmë.

E donte gjyshja, e donte këtë lumë,
se buzës së tij e kaloi të ritë,
por as ndër mend s'i shkoi asaj kurrë,
se valët e tij mund të bëheshin dritë.

1971.

LETËR NËNËS

Kjo mbrëmje erdhi e butë,
si shikimi yt, nënë e dashur;
ndizen dritat qytetit të lindjes
ndizet malli yt i pamatur.

Mendimi yt i shqetësuar
vjen e më kërkon rrugëve të gjata,
vjen ai i ngarkuar
me lodhjen që sjell nata.

Dua gjumin ta bësh të qetë
dhe nga shpirti ta flakësh shqetësimin...
Unë e krijoj jetën vetë,
kjo m'ia rrit krahët gëzimit.

1970

T E D I E L A T

Të dielat i shoh të nderura në fund të javës,
në bardhësinë e çarçafëve, ballkoneve dhe obo-
reve,
nëpër duar të vyshkura nga shkuma e bardhë,
në këmishat e djemve bulevardëve.
Të dielat i shoh të hënave,
në sytë e lodhur të grave.

1972

8781

NGA FJALËT E TIM GJYSHI

... Ditë qoftë a natë, kur të vdes,
asnjë të mos flasë për mua.
Fjalët prapa krahëve,
edhe të mira, i kam zët,
njerëzit
të më gjykojnë në sy, dua.

1972

NË 70-VJETORIN E BABAIT

Kjo ditë të vinte deshëm dhe s'deshëm,
gjersa si një zjarr ajo mban
hirin e pleqërisë,
shpuzën e jetës.

1973

SHOQES QË U MARTUA ME MBLESERI

Në objektiv i fiksova në atë çast të «lumtur»
të dy të ulur në cep të krevatit;
asaj sytë i kërkonin diçka të humbur,
ai krenar drejtonte shtatin.

Kish kaq gjëra të bukura ajo dhomë e re martese,
kish abazhuar ngjyrë rozë,
mobileri...
Por më kot ajo kërkonte të gjente aty,
pak dashuri.

1972

ELEGJI PËR DËSHMORIN MIDHI KOSTANI

Bir, kaq vjet u bënë, kaq vjet...
këtë vit në gusht mbushen plot tridhjetë.

Kjo tryezë, punuar prej teje,
po të kishte gojë, sa shumë do të rrëfente.

Në ditë feste, kur mbushet plot,
ti gjithmonë vjen, ulesh me ne tok.

Këtë natë gushti qielli ka kaq yje,
vijtë dhe të ulen, bir, ty përmbi krye.

1972

NIPIT TIM, GJERGJIT

Do të rritesh ti, do të rritesh...
dhe më për dore kështu s'do të të mbajmë,
nëpër rodhan s'do të vërtitesh,
më sheret s'do të të quajmë.

Do të rritesh ti, do të rritesh...
dhe më në gjumë s'do të të vëmë me nina-
-nana,
në orën dhjetë do të dëgjosh
lajmet e fundit që jep Tirana.

Do të rritesh ti, do të rritesh...
dhe më përparëse shkolle s'do të mbash,
s'do t'i fshehësh më poshtë bangës,
gishtat e lyera me mellan.

1971

DITA E RE

Nata lëmshin e saj mbështolli mengadalë
ndërsa çeli sytë e kaltër dita e re.
Në pasqyrë burimesh veten pasi pa,
ballin e stolisi me rreze dielli,
pastaj...
në furkën e saj
filloi të tirtë ëndrrat e njerëzve.

1965

N Ë K O N V I K T

Pse u var kështu heshtja
bashkë me pardesynë e Lilit prapa derës?
Të shqetësuara lexojnë ndër rreshta
shoqet që shikimin ulën njëherësh.

«Hë, flisni, — godet heshtjen Ana,
— ju që shoqen e doni «më shumë.»
Lili mbledh supet e njomë
dhe e mbytin mendimet.

Hyri me Lilin dashuria
si para gjyqit në konvikt
tre nga ne e mbrojtën si jetën
dy i druheshin si gjyshit fanatik.

1970

MIKJA E TIM VËLLAI

Ajo hyri në bisedën tonë
si një aromë bliri nëpër bulevard,
në sytë e tij u ul dashuria
kur përmendi emrin e saj.

Sonte më pranë se kurrë e ndjeva vëllanë,
kur më foli për këtë dashuri,
duke hapur kanatet e shpirtit,
si një shok shokut të tij.

1971

VIETNAMEZES KAI

Këngën pse e le të varur, Kai,
ç'të kujtoi vallë ajo?
Një nga vajzat tha: «Ndoshta vëllanë,
që një vit më parë mbeti në front.»

Pse heshte, Kai, pse heshte?
Ti me këngën tënde na hyn në shpirt,
por sonte atë e mbylle brenda zemrës,
kur ai erdhi dhe aty t'u ul.

Gjithmonë hapësira nuk i ndaka njerëzit;
ti atë e do dhe ai të pret
aty, nën palmën vietnameze.
ku pëlcastin bombat e dashuria çel.

1972

R R I T J E

— Poemë —

Mëhalla ime rritet çdo ditë
në këtë qytet ku dielli lëviz mes kalldrëmeve.
Mëhalla ime e vogël
me qoshket e dala brinjëve të shtëpive,
mblodhi gjurmët e fëmijnisë sime.

Një kuti konserve,
një grusht tapa shishesh,
një plloçë e vogël mes tyre,
një rreth —
ku vërtitej fëmijnia ime.

Një ditë na thanë:
të linim topat e shisheve,
të linim topat prej lecke.

ishim çupa —
të mbanim gjegjefët.
Bashkë me to të mbushnim veten
me ëndrrat e së nesërmes,
ashtu si me qindizma
thasët.

Por erdhi koha!
Thasët do të mbusheshin me grurë!
Mbi tokën e kënetës do të mbillej bukë!
Në sofatet e rrugicave të mëhallave tona
do të shtronim
rrugë të reja,
ku do të ecte lumturia me njerëzit tanë,
ku maqinat do të sillnin mes gëzimit
grurin e bardhë.

* * *

Nënat zbrazën dyshekët,
thurën me to çorape për djemtë ushtarë.
Nëpër postafet e rrugicave të mëhallës sonë
filloi të rridhte uji i bardhë.

Postafe s'do të kishin vetëm disa rrugë,
ashtu si disa hambarë grurë.
Postafet brenda shtëpive

do të lanin gjymtyrët e të gjithëve:
të baballarëve që djersa u thahej në xhaketë,
që s'kishin kohë të shihnin sa shpejt
u rriteshin çupat dhe djemtë;
të nënave shamibardha,
që ujin e sollën për shekuj mbi supe, me shtama.

Kaq shumë grurë,
kaq shumë ujë
s'kishin parë kalldrëmet tona!

* * *

Mëhalla jonë e vogël
si një gjyshe e dhëmshur na vështronte
tek na rriteshin gjymtyrët dhe habitej.

* * *

Mëhalla ime mban mend mirë
fëmijët që u rritën me bukë misri e shëllirë,
që vraponin rrugicave të saj nëpër net,
që vranë Maliq Beun me një «beretë»,
që me duart e tyre në portat e rrugicave
si një rreze drite sillnin
traktet ku shkruhej e ardhmja.

Mëhalla ime e vogël ndër shekuj mbeti.
Mëhalla ime filloi të mos ndizte pranë ikonës
kandilen,

U besoi veten,
gjithshka,
këtyre fëmijëve.

Mëhalla ime s'i harron ata kurrë!
Emrat e tyre të pavdekshëm mbetën
në rrugicat e saj,
në çdo gur!
Emrat e tyre i shkriu në një të vetëm.

Mëhalla ime e ndërroi emrin e saj të vjetër,
mëhalla ime e vogël u vetëquajt ilegale,
si bijtë e saj që ia dinin hallet.

Mëhalla ime që çupave me shekuj u mësoi gjer-
gjefin.

që i nisi te burri me vello në kokë,
që i pa tek u roniteshin ditët bashkë me lotët,
që i pa tek u tretej emri
mbi një shkorsë lecke tek avlëmendi,
ndjeu e para hapat e ilegalëve,
në gji fshehu traktin e partisë,
siç mbron nëna trupin e fëmijës,

siç mbron toka farën para se të mbijë
dhe pret pranverën që të vijë.

* * *

Mëhalla kishte kohë që s'flinte,
zanatçinjtë grushtin-çekan e fshihnin
poshtë përparësës së punës,
të nxirë nga ditët e tymosura.

Trak-çak, çak-trak,
djali i xha Kolit kishte një vajzë të dashur,
siç kanë gjithë të rinjtë.
Ajo e priste buzëmbremjeve
në sofatin e Aspasisë
dhe përshëndeteshin: «Mirë mbrëma!»
dhe ndaheshin: «Natën e mirë!»
Atë natë ajo e priti atë «mirë mbrëma» deri në
mesnatë,
përpara dritares së ljer nga nata e gjatë.
Djali i xha Kolit s'erdhi...
Djali i xha Kolit atë natë
i leu zyrat e fashos me bojën e kuqe të flakës.

Atë e varën...

Xhaketën e punës s'ia mbuloi dot çarçafi i vdekjes,

çarçafi i bardhë,
ashtu si ditët e nxira të pushtimit,
mbuloi mëhallën.
Mëhalla trupin e tij e ngriti
me guximin e hakmarrjes.
Mëhalla ime e vogël,
mëhalla ilegale!

* * *

Xha Koli paska djem të tjerë,
Shtëpia e tij mbeti hapur përherë.

Trak-çak, çak-trak,
xha Koli mbathi gjithë djemtë në mal.
Xha Koli s'bën më këpucë për zotërinjtë.

Le ta provojnë njëherë ata ç'do të thotë të jesh
zbathur,

ç'do të thotë
të kërkosh kafën e mëngjezit,
kur di se të mungon edhe kripa për bukën,
kur di se s'ke me se ta martosh çupën,
çupën që punon pajët e botës nëpër gjergjefe
dhe të vetmin fustan arnon çdo mbrëmje për vete.

Trak-çak, çak-trak,
xha Koli doli partizan.
Xha Kolin e priti mëhalla atë ditë,
kur mbi supe mbante diellin e lirisë.
Dielli hyri nëpër rrugicat e mëhallës,
tani buka e tij do të ngopte gjithë vocërrakët,
nëpër postafet do të rridhte papushim
uji i bardhë.

* * *

Mëhalla ime e vogël
njerëzit i kish të mëdhenj.
Duart e tyre rindërtonin shtëpitë shpejt.
Mëhalla ime dikur ilegale,
mori emrin e ri: «vullnetare»!

Nënat lanë avlëmendet,
ndoqën pas çupat dhe djemtë,
mbi tokat e kënetës do të mbillej grurë,
Shqipëria do të kishte të hekurtat rrugë.

* * *

Mëhalla ime rritet çdo ditë
në këtë qytet ku dielli lëviz mes kalldrëmeve.
Mëhalla ime e vogël,
me qoshket e dala brinjëve të shtëpive,
u rrite me ne, u rrite!

* * *

E bija e Taqit do të shkojë në shkollë të lartë,
e bija e Taqit që luajti me ne nëpër mëhallë,
që vraponte më mirë se një djalë.

* * *

Ku kishte njohur mëhalla ime vajzë me shkollë të
lartë?!

Ti liceistët i pe ndër vite, pas shkolle,
tek vërtiteshin pa punë ditë dhe natë.

Në një nga këto ditë Enver Hoxha
u ul në sofatin tënd
dhe nisi me ty bisedën e ngrohtë.

Ndaj këtë bisedë të gjatë t'i s'do ta harroje kurrë,
çdo ditë dhe natë do ta kujtoje,
do ta kujtoje ditëve dhe netve ilegale,
se ishte ajo bisedë, nga të gjitha gjer atëhere,
më e dashur,
më e madhe!

Mëhalla ime e vogël,
netve mbi këtë djep të madh ëndrrat i përkunde.

Kjo diçka e madhe u quajtka socializëm!
Kjo diçka e madhe botës së vjetër do t'i shkulë
çdo rrënjë të kalbur.
çdo qelizë.

* * *

E bija e Taqit shkoi në shkollë të lartë,
e bija e Taqit çdo gur ia njihte mëhallës.
Arkitekturën e re gjithë qytetit shkoi t'ia mësonte.
E përcolli atë gjithë mëhalla,
siç na përcjell nëna për një rrugë të gjatë,
siç përcjellim dallëndyshet, që do të na vijnë prapë.

Mëhalla ime ishte mësuar me përcjellje,
por të tillë përcjellje s'kishte parë kurrë
mëhalla ime e vogël,
ku na njihte dhe njihnim çdo gur.

* * *

U mësua mëhalla me përcjelljet e reja,
përcillte ditën,
përcillte natën,
çupat si djemtë i quante —
ushtarë.

* * *

Mëhalla përcillte çupat,
mëhalla priste nuset,

mëhalla mëngjezet i pret zgjuar,
pushkën si djalit dhe vajzës
ia ka mësuar!

Mëhalla ime çdo ditë rritet,
gjurmët tona vështron tek na i rritën vitet...
Mëhalla ime e vogël,
mëhalla e bijve punëtorë,
na mësoi që fëmijë:
më shumë se jetën tonë
t'i duam,
t'i mbrojmë
këto 28 mijë kilometra katrorë!

* * *

Mëhalla ime rritet çdo ditë,
në këtë qytet ku dielli lëviz asfalteve;
mëhalla ime e vogël,
me qoshket e dala brinjëve të shtëpive,
mblodhi gjurmët e fëmijnisë sime.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Portreti yt, nënë	3
Në dekadën e majit	4
Dashuri dhe urrejtje	5
Shoqes kandidate partie	7
Para dëshmorëve të lirisë	8
Kur mungon ti, Z.	10
Mëshirë	11
Motra	12
Nënës	13
Duart e tokës	14
Këtë mëngjez	16
Në kujtim	17
Në shtëpinë e vjetër	18
Mendime në breg të lumit	19
Letër nënës	20
Të dielat	21
Nga fjalët e tim gjyshi	22
Në 70-vjetorin e babait	23
Shoqes që u martua me mblesëri	24
Elegji për dëshmorin Midhi Kostani	25

	Faqe
Nipit tim, Gjergjit	26
Dita e re	27
Në konvikt	28
Mikja e tim vëllai	29
Vietnamezes Kai.	30
Britje (poemë)	31

Kopertina nga *Musa Qarri*

Tirazhi 1.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974